



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DURRËS
KËSHILLI BASHKIAK

VENDIM

Nr. 23, datë 06.03.2024

PËR MIRATIMIN PËR DHËNIEN E AUTORIZIMIT PËR NËNSHKRIMIN E AKTMARRËVESHJES SË FINANCIMIT NDËRMJET SIPËRMARRËSIT “DULE” SHPK DHE PËRFITUESIT BASHKIA DURRËS, PËR RIKONSTRUKSIONIN E QENDRËS SHËNDETËSORE SHKALLNUR, NJËSIA ADMINISTRATIVE RRASHBULL, BASHKIA DURRËS

Në mbështetje të nenit 113, pika 2 të Kushtetutës, nenit 8, pika 2, nenit 9, pika 1, nënpika 1.1 shkronja b dhe nënpika 1.2, shkronja c, nenit 54, shkronja e/1, nenit 55, pikat 3 dhe 6 të Ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 1003, datë 10.12.2010, “Për miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme publike shtetërore, që transferohen në pronësi ose përdorim të Komunës Rashbull, të Qarkut të Durrësit”, kërkesës që mban nr. 12 prot., datë 06.01.2024 të subjektit “Dule” shpk, administruar nga Bashkia me nr. 1162 prot., datë 23.01.2024, me anë të së cilës shprehet vullneti për të rikonstruktuar Qendrën Shëndetësore Shkallnur, Njësia Administrative Rrashbull, Bashkia Durrës, Ligjit nr. 7892, datë 21.12.1994, “Për sponsorizimet”, i ndryshuar, VKM-së nr. 408, datë 13.05.2015, “Për miratimin e Rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar, Udhëzimit nr.30, datë 27.12.2011, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar, dhe sipas relacionit të përgatitur nga Drejtoria Ligjore, me propozim të Kryetarit të Bashkisë,

KËSHILLI BASHKIAK
V E N D O S I :

1. Miratimin për dhënien e autorizimit për nënshkrimin e aktmarrëveshjes së financimit ndërmjet Sipërmarrësit “Dule” shpk dhe përfituesit Bashkia Durrës, për Rikonstruksionin e Qendrës Shëndetësore Shkallnur, Njësia Administrative Rrashbull, Bashkia Durrës, që mban nr. 16/3

të listës së transferimit, miratuar me VKM-në nr. 1003, datë 10.12.2010, “Për miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme publike shtetërore, që transferohen në pronësi ose përdorim të Komunës Rashbull, të Qarkut të Durrësit”.

2. Ngarkohen Drejtoria Ekonomike, Drejtoria e Planifikimit Kontrollit dhe Zhvillimit të Territorit, Drejtoria e Shërbimeve Publike, Drejtoria e Projekteve dhe Infrastrukturës Publike si dhe Njësia Administrative Rrashbull për vijimin e procedurave të mëtejshme në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të Ligjit Nr.139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar.

KRYETAR I KËSHILLIT BASHKIAK

Ani Dyrmishi



U shpall sot me datë 07.03.2024





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT DURRËS

Nr. 162 / Prot.
9

Durrës, më 18.03.2024

Lënda: Verifikim i ligjshmërise së aktit



**KËSHILLIT BASHKIAK
DURRËS**

**KRYETARIT TË BASHKISË
DURRËS**

Verifikova ligjshmërinë e Vendimit të Këshillit Bashkiak Durrës Nr.23 datë 06.03.2024 “Për miratimin për dhënie e autorizimit për nënshkrimin e akt marrëveshjes së financimit ndërmjet sipërmarrësit “DULE” shpk dhe përfituesit Bashkia Durrës, për rikonstruksionin e Qendrës Shëndetësore Shkallnur, Njësia Administrative Rrashbull, Bashkia Durrës”.

E gjej atë të bazuar në ligj dhe në bazë të kompetencave që me jep Ligji Nr.107/2016 “Për Prefektin e Qarkut”, e konfirmoj bazueshmërinë ligjore të tij.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin.

**PREFEKTI
EMILJAN JANI**

